

LIGJ
Nr. 118/2015

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 74/2015, “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJEVE NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE SHOQËRIVE “S2 ALBANIA”, SHPK DHE “RAPISCAN SYSTEMS”, INC, “PËR ZGJIDHJEN ME MIRËKUPTIM TË MOSMARRËVESHJEVE” DHE “PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT PËR FINANCIMIN, NGRITJEN DHE OPERIMIN E SHËRBIMIT TË SKANIMIT TË KONTEJNERËVE E AUTOMJETEVE TË TJERA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 123/2013”, SI DHE TË TARIFËS SË SHËRBIMIT TË SKANIMIT”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 74/2015, “Për miratimin e marrëveshjeve ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “S2 Albania”, sh.p.k. dhe “Rapiscan systems”, INC, “Për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve” dhe “Për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 123/2013”, si dhe të tarifës së shërbimit të skanimit”, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Përfshihen nga pagesat e tarifës së shërbimit të skanimit, të përcaktuara në pikat 1 e 2, të këtij neni, deklaratat doganore për:

a) mallrat e vendosura në regjimin e transitit, kur ky regjim përfundon në një zyrë doganore shqiptare për të marrë një destinacion tjetër doganor;

b) mallrat që dalin nga regjimi i magazinimit doganor drejt një destinacioni tjetër doganor, me përjashtim të rieksporit;

c) mallrat që hyjnë në magazinat e lira dhe, gjithashtu, mallrat që dalin nga magazinat e lira me procedurë rieksporit;

ç) asgjësimin e mallrave nën kontroll doganor; shkatërrimin e mallrave pas regjimit të përpunimit aktiv me rimbursim; shkatërrimin e mallrave që kanë qenë nën regjimin e përpunimit aktiv me pezullim; shkatërrimin e mallrave pas regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë; shkatërrimin e mallrave pas regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm; shkatërrimin e mallrave që kanë qenë në magazinim doganor; sistemim situatë, pas hyrjes së mallrave në magazinë të lirë; diferencën në matje; diferencën në matje në magazinë të lirë; firot natyrore pas regjimit të përpunimit aktiv me rimbursim; firot natyrore ose teknike të mallrave që kanë qenë në regjimin e përpunimit aktiv me pezullim; firot natyrore ose teknike të mallrave që kanë qenë në magazinim doganor; firot natyrore ose teknike të mallrave që kanë qenë në magazinë të lirë;

d) mallrat që vendosen në qarkullim të lirë, pas vendosjes në regjimet doganore pezulluese;

- dh) mallrat e importuara nën regjimin e përpunimit aktiv dhe produkteve kompensuese të dala prej tij (rieksport dhe destinacione të tjera, përveç hedhjes në qarkullim të lirë);
- e) transferimet nga një regjim pezullues/ekonomik në tjetrin;
- ë) importet rastësore të mallrave me natyrë jotregtare (deklarata të thjeshtuara).”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.10.2015

Shpallur me dekretin nr. 9319, datë 18.11.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani